




REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISE
AGJENSIA E SHERBIMEVE TE SPORTIT

Parku Olimpik Tirane

Nr. 334 Prot.

Tiranë, më 19.06.2016



Rregullore e funksionimit te Agjensise se Sherbimeve te Sportit

KREU I

Neni 1

Objekti

Objekti i kesaj rregulloreje eshte percaktimi i rregullave dhe detyrave te hollesishme te organizimit, funksionimit te struktures organizative te Agjensise Shqiptare te Sporteve (me poshte ASHS) dhe te mardhenieve ndermjet saj dhe Federatave Shqiptare te Sportit apo institucioneve te tjera Sportive qe kerkojne mbeshtetjen e saj.

Neni 2

Struktura

ASHS funksionon sipas struktures se miratuar nga Urdheri i Kryeministrit nr.59 dt.04.05.2016 "Per miratimin e struktures dhe te organikes se Agjensise Sherbimeve te Sportit.

Struktura e ASHS-se perbehet:

1.Drejtoria (drejtori, zv.drejtori)

- 2.Sektori i Koordinimit
- 3.Sektori i Sherbimit Mjekesor
- 4.Sektori i Fanances dhe Sherbimeve

KREU II

Qellimet dhe detyrat e strukture organizative te ASHS-se.

Neni 3

Drejtoria perbehet:

1.Drejtori

2. Zëvendës drejtori

- Drejtori dhe zv.drejtori i cili asiston drejtorin ne veprimtarine e punes se ASHS-se.
- Drejtori i ASHS-se organizon, drejton, dhe administron te gjithe veprimtarine e ASHS-se ne perputhje me detyrat e percaktuara ne statutin e institucionit dhe per kete aktivitet pergjigjet para Ministrit perkates per Sportin;
- Drejtori propozon, perpilon dhe paraqet per miratim prane Ministrit pergjegjes per Sportin ndryshimet ne strukturen e institucionit dhe ne rregulloren e brendeshme te funksionit te ASHS-se duke percaktuar rregullat e funksionimit te sektoreve, detyrat dhe pershkrimet e pozicioneve te punes per cdo specialist;
- Bashkerendon punen per hartimin e projektbuxhetit sipas rregullave dhe afateve qe percakton ligji organik per buxhetin e shtetit dhe ia paraqet per miratim Ministrit perkates per Sportin;
- Propozon programin vjetor te veprimtarive te ASHS-se dhe e paraqet tek Ministri pergjegjes per Sportin;

-Perfaqeson institucionin ne mardhenie me te tretet pervec rasteve kur kete te drejte e delegon;

-Nxjerr urdhra dhe detyra ne perputhje me misionin dhe detyrat e ASHS-se te percaktuara ne statut;

-Percakton kriteret e marrjes ne pune te personelit te ASHS-se dhe pershkrimin e vendeve te punes;

-Emeron, merr masa administrative, liron dhe shkarkon nga detyra punonjesit e ASHS-se, ne perputhje me procedurat e parashikuara ne Kodin e Punes;

Neni 4

Sektori i Koordinimit perbehet:

1.Pergjegjes sektori

2. Specialist per federatat

3. Specialist per federatat

2.Specialist jurist

Sektori i koordinimit ka keto detyra te pergjitheshme:

-Organizimin ne bashkepunim me Federatat te aktiviteteve sportive kombetare.

-Pjesemarrjen aktive ne organizimin e aktiviteteve nderkombetare ne Shqiperi.

-Sherbimin e informacionit dhe mardhenieve me jashte.

-Menaxhimin e ambienteve sportive

-Plotesimin e detyrave te tjera te ngarkuara nga Drejtori.

Specialist federatash

-Specialisti eshte personi i autorizuar qe perfaqeson Agjensine ne marredheniet me Federatat e Sportit sipas detyrave te ngarkuara nga pergjegjesi i Sektorit apo nga Drejtoria;

-Specialisti i ASHS-se mban kontakte te vazhdueshme me Federatat Sportive, kryesisht me Sekretaret e Pergjithshem, Kolegjiun e gjyqetareve;

-Kryen detyrat me te rendesishme per organizimin e aktiviteteve si: zhvillimin e ceremonise se aktivitetit; mbajne kontakte me tranieret e ekipeve; mbajne kontakte me gjyqetarin per

bazen materiale dhe vendosjen e saj ne ambjentin ku do te zhvillohet aktiviteti; per akomodimin e sportisteve; akomodimin e gjyqetareve etj;

-Kryen ndermjetesin kur ka probleme dhe mosmarreshje te ndryshme ndermjet: gjyqtar-sportist-tranier;

-Merret me zgjidhjen e problemeve organizative qe mund te dalin gjate kryerjes se aktiviteve, ceremonite e hapjes apo mbylljes se tyre, etj;

-Ne rast mosmarreshjesh mes paleve pergjegjesi i sektorit/Drejtori autorizon nje punonjes tjetër ne kete detyre;

Ne aktivitetet nderkombetare:

-Presin delegacionet ne aeroport;

-Merren me akomodimin e ekipeve;

-Njohin pjesemarrësit me materialin e aktivitetit;

-Shoqerojne delegacionet nga hoteli ne ambjentet ku do te zhvillohet aktiviteti;

-Zgjidhin problemet qe mund te dalin me akomodimin, ambjentet stervitore etj;

-Merren me te gjitha problemet dokumentare qe ekipet mund te kene me institucionet shqiptare;

-Bejne percjelljen e tyre pas mbarimit te aktivitetit;

Menaxhimi e ambienteve sportive:

-Administron ambientet sportive dhe ka te gjithë pergjegjesine qe keto ambiente te jene ne gjendje shume te mire per zhvillimin e aktiviteve. Raporton 1 here ne jave para eproreve per gjendjen e ketyre ambienteve dhe detyrimisht 3 dite para zhvillimit te aktivitetit.

3.Specialist Jurist

Juristi kontrollon bazen ligjore te te gjithë veprimtarise, dokumentacionit te ASHS-se. Perfaqesimi ligjor i ASHS-se behet nga juristi, por ne varesi te procesit gjyqesor, titullari mund te autorizojë dhe specialiste te tjere te fushave perkatese.

Neni 5

Sektori i Sherbimit Mjekesor perbehet:

1.Pergjegjes Sektori

2.Specialist (fizioterapist , infermier)

3.Ndihmes specilist laborant

Pergjegjesi i Sektorit (Mjek)

Spektori i Sherbimeve Mjekstore nen mbikqyrjen e mjekut, Pergjegjes Spektori, ka per detyre te kryeje:

-Vizita te pergjithshme e te specializuara. Programim dhe kontroll te stervitjes se sportistëve te elites apo ekipeve kombetare te cdo lloj sporti dhe te cdo moshe;

-Kontrolli periodik i sportistëve dhe dhenia e licences mjekstore nje here ne vit (ku perfshihen antropometria, vizita klinike, analizat e gjakut dhe te urines, spirometria, EKG dhe konsumi maksimal i Vo2 tek te rinjte dhe te rriturit);

-Fizioterapia dhe rehabilitimi fizik i sportistëve pas traumave te ndryshme nepermjet fizioterapise instrumentale dhe kinezoterapise;

-Analizat kliniko biokimike dhe urine, fece, dhe sekrecione per sportistet e elites;

-Kontrollin shendetesor te sportistit te ekipeve kombetare gjate stervitjes, gares apo ndeshjes si me qellimin parandalues kunder demeve te mundshme ashtu edhe per te permiresuar rendimentin sportive;

-Analizimin e gjendjes se sportistit gjate aktivitetëve sportive nga pikepamja antropologjike, psikologjike dhe klinike;

-Edukimin shendetesor te te rinjve qe praktikojne aktivitetëve sportive fizike ,gjimnastiko-adestrues;

-Kryerjen e sherbimeve te urgjences sportive apo te kurave te specializuara dhe realizimin e rehabilitimit motorrik te demtimeve sportive;

-Te kryeje funksionimin e zyrtarit permes perfaqesuesit te saj ne ndeshjet e boksit, artet marciale, mundjes, atletikes e lojrave pa te cilet nuk mund te zhvillohet asnje aktivitet sportiv ne baze te rregullave nderkombetare te percaktuara nga CIO dhe federatat boterore europiane;

-Te koordinoje dhe udheheqe mjeket sportive specialist gjate ushtrimit te kontroleve mjekstore zyrtare te detyruara ne baze te Ligjit "Per Sportin" Nr.9376 dt.21.04.2005 te pakten nje here ne vit ne te gjitha aktivitetët zyrtare brenda dhe jashte vendit per te gjithë sportistet shqiptare anetare te federative sportive shqiptare;

Fizioterapisti:

-Ndjek protokollet dhe diagnozat mjekstore te vendosura nga shefi i sektorit (mjek) dhe mjekteve te tjere specialiste persa i perket gjithë kontigjentit te sportistëve antare te ekipeve kombetare qe gjate vitit mund te kene nevojë per kurim fisioterapeutik instrumental, masazh e relaksim para e mbas aktivitetëve te ndryshme nderkombetare si dhe gjate pregatitjeve gjate ketyre aktivitetëve;

Infermierja e specializuar:

-Ke per detyre te beje te gjitha manipulimet intramuskulare e intravenoze, te perdore EKG, metodikat e bicikletes ergometrike dhe ato te pistes ergometrike, te perpunoje keto te dhena ne baze te sugjerimeve nga shefi i sektorit (mjekut);

-Te mjekojte dhe te rinovojte te gjitha plaget e hapura (mikrokirurgjikale) te shkaktuara nga traumat e ndryshme sportive tek sportistet e ekipeve kombetare te cdo lloji sporti;

- Ndhimes specialis laborant

Laborante e laboratorit te analizave te dije manipulimet intravenoze dhe gamen e analizave biokimike, gjakut koplet, urine komplet, fece parazit e sekrecione biologjike.

Disiplina ne Sektorin e Mjeksisë:

Punonjesit e sektorit te mjeksise kane detyrim te mbajne paster higjenen shendetsore te ambienteve ku punojne dhe te vishen me uniforme te bardhe.

Neni 6

Sektori i Finances dhe Sherbimeve

1. Pergjegjes sektori
2. Specialist finance
3. Arkiv-sekretari,protokoll,
4. Magazinjer
5. Teknik i mesem

Sektori i Finances ka keto detyra te pergjithshme:

-Kryerjen e aktivitetit financiar per ASHS-ne.

-Kryerjen e veprimeve financiare per llogari te Federatave.

-Plotesimin e detyrave te tjera te ngarkuara nga Drejtori i ASHS-se.

Pergjegjes sektori

-Kujdeset per realizimin e te gjitha veprimtarive ekonomike-financiare te institucionit duke respektuar me rigorozitet buxhetin e institucionit;

-Jep informacion per pasurine, gjendjen financiare, dhe rezultatet e veprimtarise financiare;

-Paraqet bilancet vjetore per drejtuesin e ASHS-se;

-Mbyll llogarite vjetore pas cdo viti ushtrimor ne baze te te dhenave te kontabilitetit dhe inventareve qe me pas paraqiten ne Ministrine perkatese per Sportin dhe ne Degen e Thesarit.

- Ben detajimin e buxhetit per te gjithë artikujt;
- Pergatit formularet e fondit te pagave, numrit të punonjesve, formularin per kryerjen e investimeve;
- Ben likujdimin e faturave per blerje te ndryshme, urdher-pagesat, urdher-xhirimet te cilat dergohen ne Degen e Thesarit cdo dite;
- Pergatit evidencat e shpenzimeve mujore. Ben rakordimin me Degen e Thesarit dhe pasi merr firmen dhe vulen nga inspektorja e Thesarit dergon nje kopje ne Ministrine perkatese per Sportin dhe informon drejtuesin e institucionit. Po keshtu vepron dhe per banken;
- Mban ditarin e bankes dhe situacionin, librin e pagave ku hedh te dhenat kontabel mbas marrjes se urdher-pagesave nga Dega e Thesarit per cdo muaj. Gjithashtu mban ditarin e magazinave dhe ben cdo muaj rakordimin e levizjeve ne magazine;
- Cdo muaj ben likujdimin e faturave me organizmat nderkombetare per pagesen e kuotizacioneve vjetore;
- Cdo muaj rakordon me Degen e Thesarit per te ardhurat e krijuara prane institucionit;
- Mban dhe perpunon dokumentacionin financiar dhe aktivitetin e federatave sportive

2.Specialist finance

- Kryen veprimime financiare per ASHS dhe federatat, në zbatim të kërkesave te Pergjegjesit te Sektorit.
- Mban librat e magazines dhe perpilon inventarin kontabël.
- Bën inventarin e ASHS së bashku me komisionin e inventarizimit dhe nxjerjes jashte perdorimit .

4. Magazinjeri

- Ben flete-hyrjet, flete-daljet per blerjet qe ben ASHS;
- Ben flete-hyrjet dhe flete-daljet per blerjet qe bejne federatat si me poshte:
 Atletika; Mundja; Peshengritja; Basketbolli; Qitja; Gjimnastika; Boksi; Karate; Shahu; Alpinizmi; dhe gjithë federatat e vogla qe varen nga ASHS;
- Mban kontakt me sekretaret e federatave per furnizimin me baze materiale per ekipet kombetare;

- Rakordon me financen e ASHS-se cdo muaj flete-hyrjet, flete-daljet;
- Rakordon me financieret e federatave te ndryshme per flete-hyrjet dhe flete-daljet;
- Ben librat e magazines se ASHS-se;
- Ben librat e magazines per cdo federate me vehte;
- Rakordon me inventaret e magazines cdo fund viti me financen e ASHS-se dhe financieret e federatave te lartepemendura;

5. Arkiv-sekretari,Protokoll

- Kryen sistemimin, perpunimin, inventarizimin, ruajtjen dhe shfrytezimin e dokumentave zyrtare qe vijne apo qe krijohen gjate aktivitetit te ASHS-se dhe te disa Federatave Sportive;
- Mban librin e protokollit per cdo vit;
- Ve ne dijeni Drejtorin mbi informacionet dhe kerkesat qe vijne ne ASHS;
- Mban vulen e institucionit

6. Teknik i mesem

- Merret me zgjidhjen e problemeve te energjise, ujit, telefonave;dhe mirembajtjen
- Zgjidhjen e problemeve te palastrave etj;
- Zgjidhjen e problemeve te transportit etj;
- Korier

KREU III

DISIPLINA

Neni 7

Orari i punës dhe qëndrimi gjatë kohës së punës

- Orari zyrtar i punës është nga e hëna në të premte 08.00-16.30. Ky orar zgjatet në mënyrën e parashikuar në ligj sipas nevojave të institucionit. Ne rast kur ka punonjes që në mënyrë të